



AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE



REVISTË,

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NR. 5, TIRANË 2018



SFIDAT & PËRFITIMET E PROCESIT TË DIGJITALIZIMIT

NGA ELKEDA DOMI

Drejtore i Planifikimit të Frekuencave dhe TIK në AMA

Tranzicioni në transmetimet digjitale televizive në Shqipëri ka kaluar përmes një rruge të gjatë dhe në përballje me një sërë sfidash, për rregullatorin, operatorët audiovizive si dhe teleshikuesit shqiptar.

Implementimi i këtij procesi në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, është realizuar përmes një bashkëpunimi të ngushtë me të gjithë palët e përfshira në këtë proces, ku një rol kryesor ka pasur edhe Autoriteti i Mediave Audiovizive.

Shtrimi i infrastrukturës numerike nga operatori publik shqiptar (RTSH) dhe 5 operatorët privat kombëtarë numerik, konsiderohet si hap i parë i rëndësishëm i cili përveç ofrimit të shërbimit televiziv nga këta operatorë do

të siguronte edhe ofrimin e shërbimit televiziv nga operatorët lokalë/rajonale në treg.

Ndërkohë që operatorët ndërtonin infrastrukturën e tyre, AMA zhvillonte aktivitete të ndryshme, të cilat do të mundësonin shfrytëzimin e këtyre rrjeteve për ofrimin e transmetimeve numerike dhe përfundimin me sukses të procesit të digjitalizimit. Ndër aktivitetet më të rëndësishme kanë qenë: lirimi i frekuencave të zëna në mënyrë të paligjshme, migrimi i operatorëve nga frekuencat që kishin në përdorim në frekuenca të tjera në mënyrë që frekuencat e rrjeteve kombëtare numerike të ishin të lira, përcaktimi i numrit logjik të programit për të gjithë operatorët në treg apo miratimi i pagesës për mbështetjen e operatorëve lokalë/rajonale në rrjetet

kombëtare. Paralelisht me këto aktivitete një vend të rëndësishëm ka zënë edhe organizimi i fushatës sensibilizuese për publikun e gjerë, në kuadër të informimit të përgjithshëm mbi procesin, si dhe detajeve të tjera teknike lidhur me mënyrat e aksesimit të transmetimeve digjitale.

Nga ana tjetër sfidë për operatorët audiovizivë kanë qenë investimet e larta për ndërtimin e infrastrukturës numerike kur ndërkohë njëkohësisht duhet të shpenzonin edhe për mirëmbajtjen e rrjeteve të tyre analoge. Mbulimi i territorit me shërbim dhe cilësia e mirë e sinjalit në të gjithë territorin ka qenë një tjetër sfidë për ta.

Ndërkohë për teleshikuesit shqiptar ka qenë e vështirë përballja me këtë realitet të ri, njohja dhe të kuptuarit e këtij procesi si dhe më pas zbatimi i tij. Sa i takon kostove të cilat implikonin teleshikuesit, ka qenë vetëm kostoja e blerjes së dekoderit, e cila është e pakonsiderueshme krahasuar me përfitimet që sjell ky proces.

Qeveria shqiptare në mbështetje të operatorëve, institucioneve të përfshira, si dhe publikut të gjerë ka financuar shuma të konsiderueshme nga buxheti i shtetit. Subvencionimi i 88 mijë dekoderave të cilët janë shpërndarë falas për familjet që marrin ndihmë ekonomike nga shteti, përcaktimi i fondeve të posaçme për AMA-n në kuadër të zhvillimit të fushatës sensibilizuese për publikun, si dhe subvencionimi i operatorëve audiovizivë me qëllim mbulimin e kostove të tyre shtesë që shoqërojnë procesin e digjitalizimit, janë disa nga nismat e rëndësishme të ndërmarra nga qeveria shqiptare.

Në bashkëpunim me të gjithë palët e përfshira në këtë proces, aktualisht është bërë e mundur mbyllja e transmetimeve analoge në tre qarqe të vendit, Berat, Korçë dhe Fier, dhe në 1 Shtator 2019 do të mbyllen edhe në qarqet Tiranë, Durrës ku është përqëndruar edhe popullsia më e madhe e vendit dhe Vlorë, ku gjithashtu

është një ndër qytetet më të mëdha në vend. Ndryshe nga finalizimi me sukses i procesit në tre qarqet e para, ndërprerja e transmetimeve analoge në qarqet Tiranë, Durrës u shoqërua me një fluks të madh të qytetarëve në pikat e shitjeve të dekoderave dhe në paqartësi nga ana e tyre lidhur me teknologjinë e dekoderave. Gjendur në këtë situatë, AMA ka zhvendosur afatin e digjitalizimit në këto qarqe deri më 1 Shtator 2019.

Kjo tregon edhe njëherë se sfidat me të cilat përballlet ky proces janë ndonjëherë edhe të paparashikuara. Megjithëse AMA ka zhvilluar fushatën e informimit prej më shumë se dy vitesh në forma nga më të ndryshmet, sërish u gjend në një situatë të papritur ku në mbrojtje të të drejtës së qytetarëve shqiptar për informim, vendosi të shtyjë afatin e digjitalizimit për qarqet Tiranë, Durrës. Më poshtë do të gjeni hartën e mbulimit të territorit të Shqipërisë me transmetime numerike nga të gjithë operatorët kombëtarë numerike. Ndërkohë Operatori Publik Shqiptar është prezent me infrastrukturën numerike në të gjithë Shqipërinë.

Pavarësisht sfidave me të cilat është përballur ky proces, në përfundim të gjithë palët e përfshira do të ndjejnë suksesin e arritur, pasi përfitimet janë të ndjeshme për të gjithë ne.

Duke filluar me përfitimet e këtij procesi në aspektin e spektrit frekuencor, vlen për t'u përmendur se kalimi nga transmetimet analoge në transmetime digjitale do të thotë administrim më i mirë i këtij spektri. Në sajë të procesit të digjitalizimit është bërë i mundur lirimi i brezit 790-862 MHz nga transmetimet audiovizive duke mundësuar përdorimin e tij për shërbimet mobile LTE, si një ndër kërkesat në rritje tashmë të konsumatorëve shqiptar. Lirimi i këtij brezi përveçse sjell përfitime për konsumatorët sjell të ardhura të konsiderueshme për buxhetin e shtetit. Nga këto të ardhura është parashikuar edhe kompensimi i operatorëve audiovizivë me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së marrjes nga publiku të të

gjitha programeve televizive të cilat më parë i aksesonin pa pagesë. Dhe kjo përkthehet në sigurimin dhe mbrojtjen e pluralizmit të informacionit dhe mediave audiovizive në vend.

Në mënyrë të përmbledhur, duke mos dashur të ndalemi shumë, pasi gjatë fushatës sensibilizuese të organizuar nga AMA, publiku është informuar lidhur me përfitimet që sjell ky proces, ndër përfitimet kryesore do të rendisja:

- **Përdorimi me efikasitet i spektrit frekuencor. Brezi i frekuencave 790-862 MHz tashmë është i lirë për t'u përdorur për shërbimet e internetit me shpejtësi të lartë, LTE (Long Term Evolution).**

- **Rritja e numrit të programeve të reja televizive me mbulim kombëtar. Nga 3 operatorë kombëtarë që kanë transmetuar në analog tashmë numri i tyre do të shkojë në 6 (përfshirë operatorin publik shqiptar RTSH), ku secili prej tyre mund të ofrojë nga 12-16 kanale televizive.**

- **Mbulimi më i mirë i territorit me sinjal numerik televiziv krahasuar me mbulimin e territorit sipas teknologjisë analoge.**

- **Rritja e ndjeshme e cilësisë së transmetimit, duke pasur parasysh edhe ofrimin e shërbimeve të reja HD.**


Theksoj edhe njëherë se procesi i digjitalizimit të transmetimeve audiovizive, konsiderohet një zhvillim i rëndësishëm në fushën e medias, pasi sjell një ndryshim rrënjësor të mënyrës së të parit televizor. Edhe pse publiku i gjerë ka hasur në vështirësi për të kuptuar këtë proces duke qenë se është një proces i lidhur ngushtë me teknologjinë inovative shumë shpejt do të kuptojë se digjitalizimi është një lajm i mirë për teleshikuesit shqiptar, është një evolucion teknologjik që duhet mirëpritur ashtu si çdo evolucion në çdo fushë tjetër.

Duke parë në perspektivë procesi i digjitalizimit pritet të ketë një impakt të ndjeshëm social në shoqërinë shqiptare, pasi rritja e numrit të programeve televizive do të çojë në shtimin e mundësive të zgjedhjeve për qytetarët tanë, dhe kjo do të çojë në rritjen e konkurrencës në treg. Automatikisht rritja e konkurrencës do të nxisë operatorët audiovizivë drejt përmirësimit të cilësisë së programeve televizive shqiptare.

MBULIMI I TERRITORIT TË SHQIPËRISË ME TRANSMETIME NUMERIKE

LEGJENDA

- Prezencë e sinjalit numerik
- Në proces digjitalizimi, përfundon në 1 Shtator 2019
- Përfunduar procesi i digjitalizimit



PYETJET MË TË SHPESHTA PËR DIGJITALIZMIN:

[HTTP://AMA.GOV.AL/WP-CONTENT/UPLOADS/2016/04/BROSHURA_AMA_DIGJITALIZIMI.PDF](http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2016/04/BROSHURA_AMA_DIGJITALIZIMI.PDF)

A disponon AMA ndonjë material informues mbi lidhjen e dekoderave DVB-T2 me televizorin dhe informacione të tjera të nevojshme për procesin e digjitalizimit?

Të gjitha këto informacione do t'i gjeni të ilustruara në Broshurën që AMA ka përgatitur që në fillim të procesit, të cilën mund ta gjeni në faqen zyrtare të AMA-s. link:

http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2016/04/Broshura_AMA_Digjitalizimi.pdf

Pse duhet të pajisem me dekoder të tipit DVB-T2?

Për të aksesuar transmetimet digjitale është e domosdoshme që të pajisni me një dekoder të jashtëm Universal DVB-T2, ose një televizor i cili të ketë të inkuorporuar këtë tip dekoderi. Caktimi i teknologjisë DVB-T2 është detyrim sipas përcaktimeve të Strategjisë së Digjitalizimit, e vitit 2012, dhe e ligjit 97/2013: "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

Çfarë duhet të bëj në mënyrë që të kem sinjal digjital në televizorin tim?

Për të aksesuar sinjalin digjital duhet të pajisni me një dekoder të jashtëm Universal

DVB-T2 ose një televizor i cili të ketë të inkuorporuar këtë tip dekoderi. Në rastin e dekoderit të jashtëm, sigurohuni që lidhja e tij me televizorin dhe antenën të jetë kryer në rregull dhe, më pas, vendosni televizorin tuaj në kërkim automatik, për të gjetur kanalet digjitale. Nëse dekoderi është i inkuorporuar në televizor, mjafton të lidhni televizorin me antenën dhe më pas ta vendosni në kërkim automatik.

Nëse nuk pajisem me dekoder, çfarë ndodh?

Nëse ju nuk pajisni me dekoder, apo televizori juaj nuk ka të inkuorporuar dekoderin e tipit DVB-T2 atëherë ju nuk do të mund të aksesoni transmetimet digjitale. Sqarojmë se procesi i digjitalizimit do të ndodhë në të gjithë Shqipërinë. Transmetime analoge do të mbyllën dhe do të kalohet në transmetimet digjitale. Procesi është menduar të zhvillohet me faza, qark pas qarku deri në mbylljen e plotë të transmetimeve analoge në të gjithë vendin. Me mbylljen e transmetimeve analoge në qarkun ku ju banoni nuk do të mund të shikoni programe televizive nëse nuk pajisni me dekoder të tipit DVB-T2.

Cilin dekoder duhet të blej, pasi në treg ka shumë lloje?

Markat e prodhimit të dekoderave mund të jenë të ndryshme, por e rëndësishme është që tipi i dekoderit të jetë Universal DVB-T2, në mënyrë që të përdorni një dekoder për të gjitha platformat numerike.

Në çfarë formati dhe rezolucioni duhet ta kem televizorin që të kem mundësi të ndjek transmetimet digjitale?

Për të aksesuar transmetimet digjitale nuk ka rëndësi se çfarë parametrash ka televizori juaj. E domosdoshme është që të pajiseni me një dekoder të jashtëm Universal DVB-T2, ose një televizor i cili të ketë të inkuorporuar këtë tip dekoderi.

Cila është lista e kanaleve që mund të ndiqen gjatë transmetimeve digjitale?

Lista e kanaleve është në varësi të qarkut ku ju banoni. Kanalet e lira (pa pagesë) që mund të shikohen, do të jenë të gjithë kanalet e operatorëve kombëtarë (RTSH-së dhe operatorëve privatë), si dhe kanalet lokale/rajonale që më parë transmetonin në analog, në qarkun tuaj.

A duhet të paguaj për të parë transmetimet digjitale?

Transmetimet digjitale ofrohen pa pagesë dhe me pagesë. Kanalet e lira (pa pagesë) janë të gjithë kanalet e operatorëve kombëtarë (RTSH-së dhe operatorëve privatë) si dhe kanalet lokale/rajonale që më parë transmetonin në analog, në qarkun tuaj. Aktualisht, në teknologjinë digjitale, mund të shikohen, të paktën, 34 kanale pa pagesë.

A duhet të pajisem me antenë apo satelit?

Digjitalizimi i transmetimeve televizive lidhet vetëm me transmetimet tokësore dhe jo ato satelitore, kablllore apo IPTV. Për të

aksesuar këto transmetime mund të provoni me antenën, që keni pasur në përdorim për transmetimet analoge, pa pasur nevojë të blini antenë tjetër.

Unë kam një televizor me dekoder DVB-T2 të integruar. Çfarë duhet të bëj që të shikoj transmetimet digjitale?

Televizorin tuaj duhet ta lidhni me antenën dhe, më pas, vendoseni në kërkim automatik për të gjetur kanalet digjitale. Duhet të keni parasysh se, ndryshe nga transmetimet analoge, ku antena mund edhe të jetë drejtuar jo plotësisht nga pika e transmetimit, për transmetimet digjitale drejtimi i antenës ka shumë rëndësi, pasi ndikon drejtpërsëdrejti në marrjen e sinjalit dhe cilësinë e tij.

A nevojitet që çdo televizor në shtëpi të pajiset me dekoder (DVB-T2) më vete?

Nëse televizori e ka të inkuorporuar dekoderin DVB-T2 nuk është e nevojshme të blini dekoder të jashtëm. Në të kundërt, çdo televizor duhet të pajiset me dekoder të jashtëm. Ofrohet edhe mundësia që të keni një dekoder të vetëm dhe me një ndarës (spliter) sinjali digjital të shpërndahet tek televizorët e tjerë, por, në këtë rast, tek të gjithë televizorët, do të shihet i njëjti kanal televiziv. Pra nuk është mundësia që në televizorë të ndryshëm të shihen kanale të ndryshme televizive.

Nëse unë e lidh televizorin me një dekoder të jashtëm DVB-T2, a duhet t'i ruaj vetë të gjitha kanalet?

Nëse e vendosni në kërkim automatik televizorin tuaj atëherë kanalet televizive digjitale do t'ju renditen sipas përcaktimeve të AMA-s. Ndërkohë, ju jepet mundësia që t'i rendisni kanalet sipas dëshirës.

Ku mund ta blej dekoderin?

Dekoderi mund të gjendet në pikat e shitjes ku tregtohen pajisje televizive si antena, kablllo

televizive, antena satelitore etj. Vetëm duhet të bëni kujdes që dekoderi të jetë i tipit universal DVB-T2, në mënyrë që të përdorni një dekoder për të gjitha platformat numerike.

Si ta lidh dekoderin me televizorin?

Mënyra e lidhjes së dekoderit me televizorin dhe antenën është shumë e thjeshtë dhe e pagabueshme. Lutemi, ndiqni udhëzimet e manualit që ndodhet në kutinë e dekoderit.

Sa kushton një dekoder i tipit DVB-T2?

Çmimi i dekoderit varion sipas llojit, markës apo vitit të prodhimit. Por AMA nuk e disponon një informacion të tillë, pasi AMA nuk ka autoritetin për të kontrolluar dhe verifikuar çmimin e dekoderave në treg.

Kur të mbarojë digjitalizimi në qarkun tim, a do mundem unë të shikoj më transmetime analoge?

Ju informojmë se procesi i digjitalizimit do të ndodhë në të gjithë Shqipërinë. Transmetimet analoge do të mbyllën dhe do të kalohet në transmetimet digjitale. Procesi është menduar të zhvillohet me faza, qark pas qarku deri në mbylljen e plotë të transmetimeve analoge në të gjithë vendin. Me mbylljen e transmetimeve analoge në qarkun ku ju banoni, nuk do të mund të shikoni programe televizive nëse nuk pajiseni me dekoder të tipit DVB-T2 ose televizor i cili të ketë të inkuorporuar këtë tip dekoderi, në mënyrë që të aksesoni transmetimet digjitale.

EFEKTET E DIGJITALIZIMIT NË ZONAT KU KA PËRFUNDUAR PROCESI

NGA TONIN PRENGA

Përgjegjës i Sektorit

të Inspektimit në Drejtorinë e Mbikëqyrjes



Sot, fjala “digjitalizim” është prej kryefjalëve më të rëndësishme, që qarkullon sa herë flitet për mediat televizive. Tashmë të gjithë e kanë dëgjuar, të paktën një herë, togfjalëshin “procesi i digjitalizimit”. Por, kur flitet për procesin e digjitalizimit, ajo që perceptohet në terma të ngushtë, është kalimi i transmetimeve nga analoge në digjitale apo në DVB-T2, siç i referohen disa. Ajo që duhet theksuar, në fakt, është se procesi i digjitalizimit është shumë më i gjerë se vetëm kaq. Ndryshimi apo kalimi i transmetimeve nga analoge në digjitale është vetëm procesi jashtëm që perceptohet, me të cilin kihen parasysh një sërë veprimesh apo masash, si dhënia e licencave kombëtare për ndërtimin e rrjetit dhe ofrimin e shërbimeve audiovizive apo ndërtimi i rrjeteve numerike, që nënkupton ndërtimin e stacioneve,

krijimin dhe implementimin e infrastrukturës përkatëse për të mundësuar transmetimet numerike tokësore. Por, përveç këtij procesi, është edhe ai i digjitalizimit të brendshëm të vetë medias, i cili përfshin digjitalizimin e krijimtarisë (prodhimeve) televizive, së bashku me krijimet (prodhimet) e mëparshme, thënë ndryshe: arkivave të mediave. Sepse, kur flitet për përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së transmetimeve, digjitalizimi i brendshëm i mediave është ai që ka rëndësi thelbësore. Mund të krijosh rrjet me pajisje dhe aparatura digjitale, për dërgimin e sinjalit të shikuesi, por pa standardet e duhura, cilësia do të jetë po njësoj, e ulët.

Përgjithësisht, një pjesë e mediave audiovizive kanë kryer ose janë vazhdimisht duke kryer investime teknologjike për të krijuar standarde dhe cilësi të larta transmetimi, për prodhimet e tyre apo ato të të tretëve, që ata emetojnë përgjatë programacionit të tyre. Megjithatë, transmetimi në teknologjinë analoge ka bërë që vetëm një pjesë e popullatës të jetë përfituese e cilësisë digjitale. Me përjashtim të familjeve që kanë një abonim në një prej subjekteve të licencuar për transmetime me pagesë (platformat televizive tokësore dhe satelitore), familjet e tjera nuk e kanë pasur mundësinë për të shijuar cilësinë maksimale

të transmetimeve digjitale, për shkak se ato kanë qenë në standardin Analog ose DVB-T.

Procesi i digjitalizimit, mbyllja e transmetimeve analoge dhe kalimi në transmetime numerike digjitale, ka krijuar mundësinë që tashmë, të gjithë, të mund të përfitojnë një cilësi më të mirë të transmetimeve edhe në programet e lira, pa pagesë.

Aktualisht, në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka mundur të përmbyllë me sukses digjitalizimin e transmetimeve audiovizive në qarqet Berat, Korçë dhe Fier, ndërkohë që është drejt finalizimit të tij edhe në rajonin Tiranë – Durrës.

Përpos debateve dhe ndikimeve të natyrave të ndryshme, impakti në publik, në qarqet ku ka përfunduar digjitalizimi i transmetimeve tokësore, duket qartë: transmetimet e reja numerike janë duke dhënë efekte pozitive, si në terma sasiore ashtu dhe në ato cilësore. Kalimi në transmetime numerike ka bërë që numri i programeve (kanaleve) të lira, pa pagesë, të rritet ndjeshëm në krahasim me periudhën e mëparshme, kur transmetimet bëheshin në teknologjinë analoge. Nga ana tjetër, buqetat e programeve pa pagesë janë shtuar, duke u bërë më të larmishme dhe më cilësore. Sot, në këto zona, shikuesi ka më shumë mundësi përzgjedhjeje, më shumë shërbime dhe ndërveprim me aparatin e televizorit dhe, njëkohësisht, atij i sigurohet një mbrojtje më e mirë për fëmijët.

Sigurisht, si çdo proces që dikton një ndryshim, edhe ky ka pasur dhe ka vështirësitë e tij. Mbyllja e transmetimeve analoge dhe kalimi në transmetime numerike, për nga ana teknike, për shikuesin, ka të nevojshme edhe ndryshimin e pajisjeve dhe aparaturave që nevojiten për të marrë sinjalin numerik dhe për ta parë atë në televizor. Pavarësisht fushatave informuese të Autoritetit të Mediave Audiovizive, njoftimeve të vazhdueshme për datën e mbylljes së transmetimeve analoge dhe pajisjeve dhe aparaturave të nevojshme

për të marrë sinjalin digjital, përsëri, një pjesë e mirë e popullsisë, në çastin e këtij kalimi, qoftë për neglizhencë, qoftë për shkaqe ekonomike, u gjend e papërgatitur dhe e pakompletuar teknikisht.

Është fakt që në të tre qarqet, ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit, ditët e para, menjëherë pas fikjes së transmetimeve analoge dhe vazhdimin e transmetimeve vetëm në numerike, u vu re një rritje e menjëhershme e shitjeve të dekoderave DVBT2, të nevojshëm për marrjen e sinjalit digjital. Sigurisht që kjo shkaktoi edhe problemet e veta, por situata erdhi dhe u stabilizua drejt normalitetit. Një tjetër problem është ai që është shfaqur në qarkun e Beratit, ku pika transmetuese e sinjalit numerik të Radiotelevizionit Shqiptar është e ndryshme nga ajo e operatorëve të tjerë privatë.


Përveç sa më sipër, disa zona ende vijnë të kenë sinjal jo të mirë dhe/ose të mos mbulohen plotësisht me sinjal numerik. Mbulimin më të mirë me sinjal e ka operatori publik, Radiotelevizioni Shqiptar, i cili arrin të mbulojë pjesën më të madhe të qarqeve ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit – Berat, Fier, Korçë – ndryshe nga operatorët privatë, të cilët mbulojnë vetëm qendrat e qarqeve dhe pjesën më të madhe të bashkive, por vijnë të dështojnë në misionin e tyre për një pjesë të mirë të njësive administrative, në rrethinat e tyre. Megjithatë, të gjithë operatorët kombëtarë të licencuar vijnë zbatimin e implementimit të rrjeteve të tyre, me qëllim arritjen e objektivit të mbulimit me sinjal edhe të këtyre zonave dhe ofrimin e shërbimeve mediatike më cilësore.

Mbetet për t’u theksuar, në përfundim, fakti i pamohueshëm se transmetimet numerike, me mundësinë për të shfaqur programe të shumëfishta dhe, njëkohësisht, me standarde më të larta, ofrojnë më shumë cilësi në raport me televizionin analog, për shërbimet mediatike audiovizive.

MBULIMI I TERRITORIT TË SHQIPËRISË ME TRANSMETIME NUMERIKE

LEGJENDA

- Prezencë e sinjalit numerik
- Në proces digjitalizimi, përfundon në 1 Shtator 2019
- Përfunduar procesi i digjitalizimit



DIGJITALIZIMI SI INTERES I LARTË PËR PUBLIKUN

NGA ARBEN MUKA

Drejtor i Programeve në AMA



Në opinionin publik, procesi i kalimit të transmetimeve televizive nga analogu në numerik, ose, siç thirret, procesi i digjitalizimit, ka marrë vëmendjen maksimale ditët e fundit. Është një ndryshim radikal në tregun audioviziv, një proces revolucionar teknik e teknologjik, që përmirëson sinjalin e emetimit të përmbajtjeve, që krijon hapësirë të shumëfishuar për përdorim frekuencash, domethënë, zgjeron numrin e kanaleve programore, por dhe ndryshon radikalisht qasjen e publikut për te konsumi mediatik i ekranit. Digjitalizimi është një akord mes vendeve të kontinentit tonë, është aplikim i një vendimmarrjeje të hershme për rregulla të reja në përdorimin e brezave frekuencorë, ku secili shtet ka të përcaktuar “sinorët” e vet për transmetimet audiovizive.

Për këtë angazhim global të nisur prej rreth 12 viteve, me rëndësi jetike për informimin, edukimin dhe argëtimin e publikut përmes shërbimeve televizive, Shqipëria zyrtarizoi një plan veprimi, përfshirë në Strategjinë Kombëtare të Digjitalizimit, miratuar nga Këshilli i Ministrave që në vitin 2012 dhe “vulën” e vuri Kuvendi i Shqipërisë përmes ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në

Republikën e Shqipërisë”. Afati ligjor dhe zyrtar, për fikjen e transmetimeve analoge, u vendos 17 qershori 2015, përmbyllje që ishte në rezonancë dhe me çka do të ndodhte me vendet e tjera evropiane.

Por deri sa planet në letra filluan të bëhen fakt, derisa sa “mrokullat” analoget të zëvendësohen totalisht me sistemet e emetimit inteligjent, procesi nisi nga zvarritjet, duke u lënë “në cep” të agjendave për institucionet dhe agjencitë publike përgjegjëse, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejt. Jo një muaj e dy, por për rreth tre vite, gjërat thujse mbetën në vendnumëro. Në një kohë që gjithçka duhej finalizuar në mes të qershorit 2015, pikërisht atëherë nisi puna seriozisht për zbatimin. Mungesa e kuorimit për vendimmarrje në Transmetuesin Publik, në Autoritetin e Mediave Audiovizive, AMA, gjurullditë e zakonshme në skenën politike, që mpiksën rolin dhe angazhimin e rëndësishëm të Komisionit Parlamentar të Medias, puna me “çerek motori” e një ekipi ndërinstitutional – këto dhe të tjera ishin sfondi që “justifikonin” mungesën, por dhe zeruan presionin e domosdoshëm të ndërkombëtarëve, të cilët, paradoksisht, nuk kishin se kujt t’i ankoheshin për vonesat.

Plotësimi nga Kuvendi i vendeve vakante në AMA, në fund të vitit 2014, riktheu vendimarrjen dhe normalitetin tek institucioni i vetëm që ligjet aktuale i kanë besuar rolin rregullator, por dhe që është një ndër aktorët e rëndësishëm në aktin e kalimeve nga analogu në numerik. Procesi i ndarjes së 7 frekuencave numerike nga AMA (5 për subjektet private të interesuara dhe 2 për RTSH-në) nuk mjaftonte për të avancuar shpejt dhe në mënyrë të sigurt me digjitalizimin.

Tregu audioviziv, me dy shtyllat kryesore, publikën dhe privaten, nuk mund të ndërtonte asnjë proces digjitalizues pa një RTSH gati. Ndaj u prit derisa përfundoi dhe maratona e lodhshme e zgjedhjes së menaxhmentit të ri të këtij institucioni. Kjo hapi rrugë për ndërtimin e dy platformave numerike, njëra për kanalet e vetë RTSH-së dhe tjetra për të bartur subjektet lokale dhe rajonale.

Çështja nuk ishte thjesht teknike dhe teknologjike, por kërkonte dhe mundim e negociim për tejkalimin e aspekteve ekonomike. Duhej përlllogaritur dhe se sa ishte kostoja e bartjes në platformën e RTSH-së për operatorët lokalë dhe rajonalë. “Antenat” e këtyre të fundit u drejtuan me të drejtë vetëm te ky tregues. Nga shifra stratosferike e fillimit, që ishte 5760 euro për muaj, falë këmbënguljes së AMA-s në negociatat e drejtpërdrejta me RTSH-në, si dhe në forumet që u zhvilluan me prezencën e operatorëve të interesuar, shifra arriti të reduktohej në 2150 euro në muaj. Plus kësaj, për të bërë të mundur përfshirjen e çdo operatori ekzistues analog në procesin e kalimit në numerik, për vitin e parë të bartjes në platformat digjitale, u arrit te një mbështetje në formën e rimbursimit nga shteti: përdorimin e fondit të të ardhurave që sigurohen nga shfrytëzimi i brezit të Dividendit Digjital në teknologjinë mobile.

Digjitalizimi lidhej gjithashtu dhe me menynë programore, me ndërtimin e buqetës me 12 programe të vetë RTSH-së, duke i qëndruar rigorozisht kërkesat e Kontratës së Shërbimit

të këtij institucioni, miratuar nga AMA. Qytetarët, pavarësisht kuptimeve të limituara mbi ndryshimet teknike e teknologjike të këtij procesi (e natyrshme kjo në kushte të tilla) mbeten me një pritmëri të lartë për cilësinë dhe larminë e katalogut programor.

Pajisja e qytetarëve me dekoder ka qenë një tjetër aspekt, ku bazuar në vendimet e bordit të AMA-s, si dhe të Këshillit të Ministrave, kjo pajisje duhej të ishte unike në të gjithë tregun, domethënë, kudo të shpërndahej një tip, DVB-T2, që lejonte përdorim për të gjitha platformat numerike të licencuara. Autoritetet doganore kanë pasur dhe kanë përgjegjësinë ligjore për të lejuar hyrjen në tregun shqiptar vetëm të tipit të dekoderave për teknologjinë DVB-T2, që shpërndahen për popullatën përmes të paktën 8 kompanive tregtare të mëdha dhe një rrjeti njësisht të vogla në të gjithë vendin.

Për personat që mbështeten nga skemat e ndihmës ekonomike dekoderi është shpërndarë falas. Rreth 88 mijë dekodera, të cilët u shpërndanë tek popullata për ata që trajtohen me ndihmë ekonomike nga shteti, garantojnë se kjo shtresë me nevoja të theksuara sociale ekonomike mori si mbështetje aksesin për të vijuar ndjekjen e programeve të dy platformave numerike të Transmetuesit Publik, në plotësim të së drejtës bazike për informim.

Nevoja e pajisjes së qytetarëve me dekoder, si dhe familjarizimi i tyre me transmetimin digjital, por dhe orientimi i operatorëve lokalë e rajonalë në procesin e bartjes së tyre në platformat numerike – ishin në qendër të fushatës ndërgjegjësuere e informuese që zhvilloi, prej rreth dy viteve, AMA. Duke qenë se procesi i digjitalizimit do të bëhej me hapa, duke testuar një pas një qarqe të ndryshme, mesazhet nëpërmjet emisioneve dhe kronikave televizive, spoteve dhe njoftimeve me tekst dhe të animuara, u fokusuan me prioritet në komunitetin ku kryhej kalimi nga analogu në numerik.

Realizimi me sukses i digjitalizimit në qarkun e Beratit vitin e kaluar, por dhe në Korçë e Fier këtë vit, përballimi në kohë dhe me efektivitet i problematikave të izoluara në të tre këto njësi administrative, janë tregues konkretë se paketa e masave dhe fushata ndërgjegjësuere e informuese ishin realizuar më së miri. Zbatimi i procesit të digjitalizimit në qarqet e Tiranës dhe Durrësit, ku ka një përqendrim më të madh të popullatës dhe të operatorëve televizivë evidentoi një avari, që bëri të detyrueshme shtyrjen e kohës së fikjes së sinjalit analog me 4 muaj. Gatishmëria e lavdërueshme e të gjithë operatorëve lokalë dhe rajonalë për të ikur përgjithmonë, më datën 10 shtator 2018, nga frekuencat historike analoge nuk mjaftoi për ta finalizuar procesin.

Monitorimi i situatës në terren nxori në pah se një pjesë e popullatës nuk kishte siguruar ende dekoderin, për më tepër, radhët e gjata dhe grumbullimet në pikat e tregtimit nuk premtonin numër të mjaftueshëm për të plotësuar të gjitha kërkesat në një kohë të shkurtër.

Një situatë vërtet e pafavorshme për qytetarët, por që stimuloi andej këtej hamendësime dhe “tablo sinoptike”, pa fakte e shifra konkrete të shpjegimit të situatës, që provokoi vende-vende në hapësirën mediatike klasike dhe atë të re, deri dhe derdhje lotësh, që trimëroi dhe tipa të flashkët, të cilët gjetën rastin të bëjnë “hypxhixhi”-n nga ky kombinim rrethanor.

Por lotderdhësit dhe “hypxhixhi”-stët nuk para merren seriozisht. Me rëndësi mbetet thelbi i kritikave dhe sugjerimeve me sens gjatë këtyre ditëve reflektive, të cilat kërkojnë zgjidhje dhe vëmendje të shtuar deri në mbylljen e procesit.

Disa muaj kohë janë shumë, por dhe pak, për ta përmbyllur objektivin e digjitalizimit në qarqet e Tiranës dhe Durrësit. Përgjegjësitë e çdo institucioni dhe agjencie përgjegjëse do të japin efekt pozitiv nëse koordinohen mes tyre dhe nëse vendosin mbi çdo gjë interesin e lartë të publikut, garantimin e të drejtës

për informim edhe në kushtet e përdorimit të teknologjisë së avancuar audiovizive.

SFIDAT E PROCESIT TË KALIMIT NGA ANALOGU NË NUMERIK NË TREGUN MEDIATIK

NGA DR. RRAPO ZGURI

Pedagog i Departamentit të Gazetarisë dhe
Komunikimit në Universitetin e Tiranës



Migrimi i transmetimeve televizive në ekosistemin digjital është një proces që po ballafaqohet me një numër sfidash të rëndësishme, përballimi i të cilave do të përcaktojë edhe vetë të ardhmen e kësaj industrie.

Historikisht, televizioni tradicional analog ka qenë dominuar nga tipologjia lineare e transmetimit. Nën këtë tipologji, televizioni si medium ishte i limituar kryesisht në funksionet e një “kanali” përcjellës të informacionit. Me kalimin në mjedisin digjital, krijohen mundësitë që mediumi tradicional i videos të transformohet, gjithnjë e më shumë, nga një kanal televiziv në një shërbim televiziv. Në pikëpamje të tregut kjo do të thotë një kalim nga tregu i orientuar prej ofertës, tek tregu

i orientuar nga kërkesa, përmes ofrimit dhe mundësisë së përdorimit të shërbimeve që janë të pavarura nga skeda e programacionit linear dhe që kanë nivel të lartë të përshtatjes sipas zgjedhjeve dhe kërkesave të konsumatorit.

Në betejën për mbijetesë dhe sukses, në këtë periudhë tranzicioni, televizionit i duhet të përballojë si sfidat që vijnë nga brenda sistemit edhe sfidat që vijnë nga jashtë sistemit.

Një nga sfidat më të rëndësishme lidhet me faktin që procesi i digjitalizimit është i ekspozuar në një masë të konsiderueshme ndaj rrezikut të përqendrimit. Në Shqipëri, investimet private në fushën e digjitalizimit të mediave audiovizive nisën përpara se të krijohej infrastruktura ligjore rregulluese në këtë fushë dhe praktikisht, kur nisi procesi, vendi u gjend në situatën e “tokës së zënë”. Kjo favorizoi një lloj pabarazie në start, por nga ana tjetër kompanitë që investuan në teknologjinë digjitale, shtruan rrugën për një proces të vështirë dhe të kushtueshëm dhe rritën sigurinë e suksesit të procesit.

Të gjendur në një lloj situatë monopolistike, operatorët e licencuar duhet të jenë dyfish të obliguar që të mundësojnë akses të drejtë dhe të barabartë për të gjithë operatorët e tjerë. Çdo lloj përpjekje apo marrëveshje e hapur apo

e fshehtë që do të shkonte në kundërrjedhë me parimin e aksesit të drejtë dhe të barabartë do të dëmtonte seriozisht pluralitetin dhe do të përbënte një subjekt ndëshkimi nga ana e autoriteteve të konkurrencës. Siç theksohet edhe në Udhërrëfyesin e OSBE-së për Digjitalizimin, përqendrimi mund të pranohet vetëm nëse kombinohet me garanci për një pluralizëm të sistemit.

Një sfidë e rëndësishme për procesin është edhe krijimi i mundësive dhe i kushteve të përshtatshme për operatorët lokalë që ata të mos mbeten jashtë sistemit. Nga TVSH, si zotëruese e rrjetit ku do të “strehohen” operatorët lokalë, duhet të aplikohet një qasje përfshirëse si dhe një politikë çmimesh që do të garantonte hyrjen në treg këtyre operatorëve. Nuk mund të ketë sukses procesi i digjitalizimit, nëse ai lë jashtë tregut mediat lokale.

Sfida tjetër e procesit të digjitalizimit lidhet me rrjedhojat sociale të tij. Dihet se digjitalizimi është një proces i kushtueshëm dhe operatorëve të licencuar iu është dashur të kryejnë investime të shumta për të ndërtuar infrastrukturën përkatëse. Ndërkohë kthimi i investimit nuk pritet të jetë një proces i shpejtë. Por kjo nuk duhet të përdoret për të justifikuar politika çmimesh që shkarkojnë në një masë të konsiderueshme koston të publiku i gjerë.

Aksesi përmes dekoderave në programet dhe në shërbimet televizive, në një farë mënyre, mund të limitojë zgjedhjet për publikun, edhe pse vetë digjitalizimi si proces supozohet t'i shumëfishojë këto zgjedhje. Kjo situatë së paku duhet të jetë e përkohshme, dhe nuk duhet të shfrytëzohet nga operatorët e licencuar për të imponuar si çmimet ashtu edhe spektrin e zgjedhjeve të konsumatorëve.

Siç theksohet edhe në Rezolutën e ITU (International Telecommunication Union), procesi i digjitalizimit duhet të ketë në qendër njeriun. Në këtë sens operatorët e licencuar duhet të garantojnë një qasje të lirë të të gjithë

qytetarëve në shërbimet digjitale audiovizive, duke shmangur përjashtimet, dhe sidomos përjashtimet nga shërbimet pa pagesë si dhe nga programet televizive trans-nacionale.

Krahas rolit të shtuar të operatorëve privatë, procesi i digjitalizimit duhet të afirmojë një rol në rritje edhe për shërbimet publike të transmetimit. Kalimi në ekosistemin digjital e rrit edhe më tej rëndësinë e radiotelevizionit publik për të siguruar pluralizmin e opinionëve dhe veçanërisht për të garantuar aksesin në media të pakicave kombëtare, të shtresave të paprivileguara si dhe të grupeve vulnerabël. Aktualisht RTSH-ja ka në spektrin e kanaleve të veta edhe kanale që shërbejnë në këtë drejtim.

Duke njohur faktin se operatorët privatë i krijojnë më pak hapësirë diversitetit dhe përfaqësimit të të gjitha kategorive të popullsisë, është e domosdoshme që të gjitha programet e RTSH të jenë pjesë e paketave pa pagesë që ofrohen edhe nga këta operatorë. Kjo do të ndihmonte edhe për reduktimin e pabarazive si dhe për një pluralizëm më të madh në mediat televizive.

Përveç sfidave të brendshme të sistemit, industrisë televizive do t'i duhet të përballojë edhe sfidat që vijnë nga jashtë sistemit. Përballimi i konkurrencës që vjen nga interneti është një prej këtyre sfidave. Shërbimet audiovizive, të ofruara nga platformat OTT, IPTV apo nga Internet TV, po njohin një rritje gjithnjë e më të madhe. Nga ana tjetër, videoja e internetit ka përparësi të dukshme në aspektet e shkallës së interaktivitetit, mobilitetit dhe përshtatjes sipas kërkesave apo interesave të konsumatorëve.

Përballimi i këtyre sfidave kërkon shndërrimin e televizionit në një medie hibride që duhet t'i afrohet gjithnjë e më shumë modelit të funksionimit të medias së bazuar te kompjuteri, por, natyrisht, pa e humbur tërësisht identitetin e tij.

PROCESI “I KOMPLIKUAR” I DIGJITALIZIMIT TË TRANSMETIMEVE

NGA DILFIRUS VRIONI



Përgjegjëse për Marrëdhëniet me Jashtë
dhe Publikun në AMA

Një historik i shkurtër

Në vitin 2012, qeveria miratoi vendimin për Strategjinë Kombëtare për Kalimin nga Transmetimet Analoge tek ato Digjitale. Sipas vendimit, brenda datës 17 qershor të vitit 2015, asnjë televizion shqiptar nuk mund të transmetonte më në analog, portë gjithë duhet të kalonin në transmetime digjitale. Vendimi për të kaluar në transmetime digjitale ishte i diktuar nga zhvillimet e reja teknologjike dhe është një detyrim që Shqipërisë i rrjedh nga Marrëveshja e vitit 2006 GE 06, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës, në vitin 2007.

Kalimi nga transmetimet analoge në transmetimet numerike është një proces global i detyrueshëm për të gjitha vendet, që koordinohet nga Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve, ndryshe i njohur si ITU. Shqipëria bën pjesë në rajonin 1, sipas ndarjes territoriale të ITU-së. BE dhe ITU e kanë bërë të detyrueshëm, për të gjitha vendet anëtare, kalimin nga analog në digjital për arritjen e përdorimit më efektiv të frekuencave. Frekuencat janë pasuri e kufizuar. Transmetimi digjital zë shumë më pak hapësirë frekuencash se sa ato në analog. Ose, e thënë ndryshe, për të njëjtin brez frekuencash transmetimi digjital siguron disa herë më shumë kanale se sa ai analog.

Muajt e fundit, fatmirësisht, u fol në media për procesin e digjitalizimit të transmetimeve televizive. Edhe pse ky proces ka kohë që ka nisur edhe AMA ka kohë që bën ç’është e mundur që televizionet, radiot dhe gazetatat të marrin vëmendjen e publikut në lidhje me procesin, por, me sa duket, deri në momentin që u ndërpreu transmetimet për qarkun e Tiranës dhe Durrësit të gjithë ishin “të painteresuar”.

Digjitalizimi po ndodh

Pra, siç u kuptua, digjitalizimi as nuk ka nisur sot, as nuk është një pikë që mund të shmanget nga AMA apo nga ndonjë institucion tjetër, ashtu sikurse edhe teknologjia që do të përdoret, pra dekoderat e tipit universal DVB-T2, me ndërfaqe të përbashkët. Apo në rastin tjetër, televizorët që e kanë të inkorporuar këtë tip dekoderi. Pra, kur themi duhet blerë dekoder, nuk themi duhet blerë një platformë private por një dekoder universal, i cili ju jep aksesin në 34 kanalet pa pagesë.

Nga ana e saj, AMA e ka pasur shumë të qartë rolin e përcaktuar nga Strategjia. AMA ka informuar publikun mbi procesin e digjitalizimit të transmetimeve. AMA ka gati dhe ka shpërndarë në çdo aktivitet të saj Broshurën Informuese, ku i jepet përgjigje të gjitha pyetjeve mbi procesin. Po ashtu, edhe fletëpalosjen, ku gjendet informacioni i koncentruar. Në radio dhe televizione, që nga prilli i vitit 2016, janë dhënë rreth 300 intervista nga specialistë dhe teknikë të AMA-s, ku kanë shpjeguar aspekte të veçanta të procesit. Reklamata, ku është shpjeguar ana teknike, nuk kanë munguar, përgjatë gjithë periudhës së fushatës së informimit të publikut. Dy numra telefoni kanë qenë në dispozicion të të interesuarve mbi procesin që nga prilli 2016. Po ashtu, janë organizuar takime me operatorët edhe konferenca ndërkombëtare në lidhje me digjitalizimin e transmetimeve, janë publikuar edhe botime shkencore. A mund të bëhej më shumë? Natyrisht që mund të bëhej.

Siç e kuptoi i gjithë publiku transmetimet digjitale operojnë me sukses tanimë në qarkun e Beratit, Fierit dhe Korçës. Sa për qarkun e Tiranës dhe Durrësit disa herë është shtyrë afati për të filluar transmetimet digjitale, kjo sepse njerëzit nuk kanë qenë gati, si me shumë mundësi nuk do ishin bërë asnjëherë gati, duke filluar së pari nga familja ime. Prindërve të mi ua kisha thënë disa herë që transmetimet do të ndërpriteshin në datë 10 shtator por ata nuk më morën seriozisht, derisa në mëngjesin

Qershori 2015 u vendos nga GE 06 dhe, më pas, u mbështet edhe në ligjin 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë” si afat fundor për kalimin e të gjitha transmetimeve në digjital, detyrim ky i përcaktuar dhe i sanksionuar nga Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve.

Pra, siç kuptohet, transmetimet që po ndërpriten në vitin 2018, në çdo qark, njëri pas tjetrit, në fakt, duhej të ishin ndërprerë tre vite më parë. Nga qershori 2015 deri në shtator 2018, Shqipëria ka mbi tre vjet që shkel marrëveshjen GE 06 dhe, për këtë, disa herë, i është tërhequr veshi nga BE. Në Progres Raportin e Vitit 2018 thuhet qartë se Shqipëria duhet të fokusohet në finalizimin e procesit të përmbylljes së digital switchover, lirimin e dividendit digjital, rishikimin e planit kombëtar të frekuencave me objektiva dhe targete të qarta.

“Duke marrë parasysh zhvillimet teknologjike, mundësitë e përfitimit ekonomik dhe përdorimit më efektiv të spektrit të frekuencave, rekomandohet që Shqipëria të kalojë direkt në implementimin e sistemit më të avancuar DVB-T2.” Kështu citohet në VKM-në nr. 292 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Kalimit nga Transmetimet Analoge në ato Digjitale.”

Duhet të përmendim në historinë e digjitalizimit edhe Radio Televizionin Shqiptar, një aktor tjetër shumë i rëndësishëm i procesit, i cili ka ndërtuar rrjetin në të cilin kanë vendosur të mbështeten një pjesë e madhe e televizioneve. Rrjeti, i ndërtuar nga RTSH, është i teknologjisë DVB-T2, si një zgjerim i standardit ekzistues DVB-T. Një zgjerim i tillë rezulton në rritjen me 30-50% të efektshmërisë së DVB-T2, kundrejt DVB-T, teknologji e cila është miratuar në Strategjinë Kombëtare të Kalimit nga Transmetimet Analoge në ato Digjitale.

e datës 10 shtator televizori nuk po shfaqte asnjë kanal.

Në këtë pikë dua të qartësoj se kanalet, në datën 10 shtator 2018, ishin në transmetim me programet që ato ofrojnë. Asnjë kanal nuk iu ndërpre sinjali nga AMA. Të gjitha familjet e pajisura me dekoder DVB-T2 apo me aparat televizori që e ka të inkuorporuar këtë lloj dekoderi vazhduan të shihnin të qetë transmetimet. Të tjerët, ata që prej prillit 2016, nuk i kishin dëgjuar thirrjet e AMA-s për kalimin e transmetimeve nga analoge në digjitale, mbeten pa sinjal, kjo si neglizhencë e tyre. Por është i dallueshëm fakti që AMA nuk i ka mohuar informacionin qytetarit.

Nga ana tjetër, si institucion që ka detyrime për të përmbushur, duhet që ta kryejë procesin dhe ta përfundojë në gjithë territorin e vendit. Pra, AMA nuk ka shkelur asnjë të drejtë kushtetuese të popullit të Republikës së Shqipërisë.

Qytetarët, besoj se me interesin e lartë që kanë për median audiovizive, do t'ia krijojnë kushtet vetes për të pasur pajisjet e duhura teknologjike, tani që e kuptuan ku konsiston procesi, i cili nuk ka kthim mbrapa. Deri më sot, 88 mijë dekodera janë shpërndarë falas për familjet që janë përfituese të skemës së ndihmës sociale, të mundësuar këto nga qeveria. Siç i është subvencionuar për vitin e parë taksa për mbartjen e rrjetit të televizioneve lokale, rajonale, në një prej platformave digjitale që operojnë në treg.

Shqipëria është ndër vendet e fundit në rajon që është duke kryer procesin.

E dimë që për shumë prej familjeve shqiptare është e vështirë përqaftimi i një teknologjie të re. Ky proces ka marr kohën e tij edhe në vendet fqinje. AMA nga ana e saj është e angazhuar me gjithë stafin, që informacioni të shkojë te qytetari dhe të kalohet ky moment delikat. Po ashtu, kërkojmë edhe mbështetjen e gazetarëve, opinionistëve dhe kujtdo që ka akses në publik, që të ndihmojë për të qartësuar

situatën dhe jo për të krijuar konfuzion.

Digjitalizimi po ndodh, ky është lajm i mirë, le të mundohemi, të gjithë bashkë, që lajmi i mirë të përbëjë lajm. Askush nuk do mbesë pa sinjal, të gjithë do kenë, në shtëpitë e tyre, transmetime me cilësi më të mirë dhe larmi më të madhe programesh.

Informohuni mbi

digjitalizimin në numrat:

CALL CENTER

 04 4104455 / 04 4104456

Disa Fakte Për Digjitalizimin

Digjitalizimi është një proces i përfunduar në gjithë Bashkimin Evropian.

Sinjalet digjitale janë më cilësore dhe për programet ka më shumë larmi në zgjedhje.

Programet digjitale janë të shumta dhe ofrohen në numër më të vogël frekuencash.

Sfidave të kohëve të sotme si: edukimi mediatik, barazia gjinore në ekrane, mbrojtja e fëmijëve, aksesimi i programeve nga grupe speciale, digjitalizimi u përgjigjet me programe të veçanta dhe përfaqësuese.

Digjitalizimi ka krijuar një mjedis të ri në media.

Digjitalizimi do t'i detyrojë autorët e programeve të mendojnë më shumë për përmbajtjen.

Përmbajtjet programore nuk do të jenë më të lidhura pas një logoje mediatike.

Procesi i kalimit të transmetimeve në digjital është realizuar në kohë të ndryshme në vende të ndryshme; në disa vende është zbatuar në fazë, si në Australi, Brazil, Indi, Meksikë dhe Mbretërinë e Bashkuar, ku çdo rajon ka pasur një datë të veçantë për ndërprerjen e transmetimeve analoge.

Më 3 gusht 2003, Berlioni u bë qyteti i parë në botë që fiku sinjalin analog tokësor.

Luksemburgu është shteti i parë që fiku sinjalin analog tokësor, në shtator 2006.

Teknikisht, Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda ishin vendet e para që fikën sinjalin analog - në formën e televizionit satelitor më 28 shtator 2001 - por sinjalet tokësore, në të dy vendet, nuk u ndërprejnë deri në vitin 2012.





Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë.

Cel: +355 67 303 3000

e-mail: Info@ama.gov.al

www.ama.gov.al